



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.72, datë 20/12/2005

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË BURSIVE TË SHETIT
NXËNËSVE DHE STUDENTËVE TË VITEVE TË PARA
PËR VITIN MËSIMOR 2005-2006”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 11, pika 3/a, neni 12, pika 4 dhe neni 32, gërma “n”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.688, dt.26/10/2005 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike”, si dhe Planit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me shkresë me Nr.7622 Prot., dt.11/11/2005, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë dhënien e bursave të shtetit nxënësve dhe studentëve:

Brënda kriterit (4 bursa të plota)

- **Gazmen Elmaz Uzeiri**, Universiteti Bujqësor i Tiranës, dega Agrobiznes”.
- **Nazmie Ferhat Seferazi**, Universiteti “A. Xhuvani”, Fakulteti i Mësuesisë për klasat I-IV dhe Parashkollor, dega “Cikli i Ulët”.
- **Fitim Avni Domi**, Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dega Anglisht.
- **Armanda Sali Hoxha**, Universiteti i Korçës, Fakulteti i Ekonomisë, dega Financë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI